



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2018:030116

Datë: 24.07.2018

Numri i dokumentit: 00088311

P. nr.447/17

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË-Departamenti i përgjithshëm, Gjyqtarja **DIANA SINA**, me sekretaren juridike Lamije Kuqi, në çështjen penale kundër të akuzuarit P. T. nga Gjakova, për shkak të veprës penale, lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.1 të KPRK-ës, sipas Aktakuzës të Prokurorisë Themelore-Dep.përgjithshem në Gjakovë, PP.nr.246/17 të datës 11.07.2017, në shqyrtimin fillestar, të mbajtur më datën **18.07.2018**, në prani të Prokurores së shtetit Mone Syla, të akuzuarit, të dëmtuarave, të njëjtën ditë mori dhe shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari **P. T.**, nga i ati S., e ëma C., e gjinisë D., data e lindjes . . . në Gjakovë, ku dhe tani banon në rrugën “...- Lagja ... i martuar- atë i 2 fëmije, ka të kryer shkollën e mesme, punëtor, i gjendjes së mirë ekonomike, shqiptar-shtetas i Republikës së Kosovës.

Ë s h t ë f a j t o r :

Sepse: Me dt.17.02.2017 rreth orës 23:15 min.,në Gjakovë-Lagjai shkakton lëndime trupore të dëmtuarave,në atë mënyrë që deri sa të dëmtuarat ishin dal për të përcjellur mysafiren e cila ishte në vizitë i akuzuari me të shpejtë del nga shtëpia e tij e të dëmtuarave ju drejtohet me ton të lartë e fjalë “Pse po vjen kjo kurv me ndejt te ju, nuk dua me e pa këtu”, e kur e dëmtuara Q. të akuzuarit i thotë se “kjo është shtëpia e jonë” e sulmon fizikisht dhe e shtrëngon në fyt si dhe e ofendon me fjalët “kurv” e godet me shuplaka fytyrës e kur e dëmtuara M. ndërmjetëson të njëjtën e shtyn dhe e godet me shuplaka e nga goditjet të dëmtuarat Q. F. T. e M. V. T. nga Gjakova Rr.”D.V.”- D. u shkakton lëndime të lehta trupore të përshkruara në ekspertizën mjeko-ligjore të Dr.M. G. dt.04.05.2017.

- me çka ka kryer veprën penale, lëndim i lehtë trupor, nga neni 188 par.1 të KPRK-ës.

Gjykata në bazë të nenit 4,17 par.1,41,49,50,51,73, 188 par.1 ë KPRK-dhe nenit 365 të KPPK-së, i shqipton:

DËNIM ME KUSHT

Dënim me burgim në kohëzgjatje prej **120.-(Njëqindë e njëzet)ditësh**, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari brenda kohës së verifikimit në afatin prej **1(Një) viti**, nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale.

Detyrohet i akuzuari që në emër të shpenzimeve procedural në emër të akt ekspertimit mjeko- ligjore të paguaj shumën prej **20.00 (Njëzet)Euro**, dhe në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej **30,00.-Euro**, e krejt këto në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi.

Të dëmtuarat Q. F. T. e M. V. T.nga Gjakova, Rr.”...”-D., për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohen në kontest civil .

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjakovë, pranë kësaj gjykate, ka parashtruar aktakuzën PP.nr.246/17 të datës 11.07.2017, kundër të akuzuarit P. T. nga Gjakova, për shkak të veprës penale, lëndim i lehtë trupor, nga neni 188 par.1 të KPRK-ës, Prokurori i shtetit në shqyrtimin fillestar ka qëndruar në tërësi pranë aktakuzës kundër të akuzuarit, andaj i ka propozuar gjykatës që i njëjti të shpallet fajtor dhe të dënohet sipas ligjit.

I akuzuari P. T gjatë shqyrtimit fillestar lidhur me fajësinë deklaron, se e pranon fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohem, për të cilën vepër jam penduar pa masë dhe premtoi para gjykatës se të njëjtën nuk do ta përsërisë, kjo ka qenë hera e parë që unë kam kryer një vepër të tillë, ditën kritike kur familjaret e mij i kam parë të shoqëruar me persona të pa dëshiruar kam reaguuar ashtu siç është përshkruar edhe në dispozitiv të aktakuzës, po atë reagim e kam bërë në afekt, por në të ardhmen unë do të kujdesem vetëm për familjen time, dhe nuk do të përzihem në familjen e të dëmtuarave, shton se prej asaj dite me të dëmtuarat nuk kam pasur asnjë mosmarrëveshje as që do të kem në të ardhmen, jam punëtor dhe mbajtës i vetëm i familjes, andaj i propozoi gjykatës që ti merr parasysht këto rrethana me rastin e shqiptimit të llojit dhe lartësisë së dënimit.

E dëmtuara Q. T. deklaron, unë si palë e dëmtuar nuk e kundërshtoi pranimin e fajësisë të bërë nga ana e të akuzuarit P. T. dhe i bashkëngjitëm ndjekjes penale dhe kërkoi kompensimin e dëmit.

E dëmtuara M. T. deklaron, unë si palë e dëmtuar nuk e kundërshtoi pranimin e fajësisë të bërë nga ana e të akuzuarit P. T. dhe i bashkëngjitëm ndjekjes penale dhe kërkoi kompensimin e dëmit.

Duke u deklaruar lidhur me mendimin lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit, prokurori i shtetit ka deklaruar se nuk e kundërshton pasi që i akuzuari ka pranuar fajësinë me vullnet dhe vetëdije të plotë dhe e njëjti ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë dhe se pranimi i fajësisë u bë në mënyrë të vullnetshme dhe se pranimi mbështet ne faktet dhe provat që përmban aktakuza.

Në shqyrtimin fillestar gjykata ka vërtetuar këtë gjendje faktike:

Në tërësi u vërtetuar se i akuzuari P. T.: Me dt.17.02.2017 rreth orës 23:15 min., në Gjakovë-Lagja ... shkakton lëndime trupore të dëmtuarave, në atë mënyrë që deri sa të dëmtuarat ishin dal për të përcjellur mysafiren e cila ishte në vizitë i akuzuari me të shpejtë del nga shtëpia e tij e të dëmtuarave ju drejtohet me ton të lartë e fjalë “Pse po vjen kjo kurv me ndejt te ju, nuk dua me e pa këtu”, e kur e dëmtuara Q. të akuzuarit i thotë se “kjo është shtëpia e jonë” e sulmon fizikisht dhe e shtrëngon në fyt si dhe e ofendon me fjalët “kurv” e godet me shuplaka fytyrës e kur e dëmtuara M. ndërmjetëson të njëjtën e shtyn dhe e godet me shuplaka e nga goditjet të dëmtuarat Q. F. T. e M. V. T. nga Gjakova Rr.”...”- D. u shkakton lëndime të lehta trupore të përshkruara në ekspertizën mjeko-ligjore të Dr.M. G. dt.04.05.2017.

Gjykata gjendjen e këtillë faktike e ka vërtetuar nga vet pranimi i fajësisë nga i akuzuari, i cili në shqyrtimin fillestar vullnetarisht ka pranuar fajësinë, për shkak të cilës gjykata nuk ka administruar provat, gjykata ka ardhur në përfundim se pranimi i fajësisë nga i akuzuari është bërë në pajtim me nenin 248 të KPP-së. Gjatë pranimit të fajësisë gjyqtarja e vetme gjykues konstatoi se i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit, pranimi është bërë vullnetarisht nga i akuzuari, pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjet që përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga Prokurori i shtetit dhe çdo provë tjetër dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

Gjykata nga të cekurat më lartë ka ardhur në përfundim se në veprimet e të akuzuarit formohen të gjitha elementet e qenies së veprës penale të përshkruar si në shqiptim të këtij aktgjykimi dhe për këtë ka vendosur që të akuzuarin të shpall fajtores dhe të gjykojë në bazë të ligjit, e më parë duke vërtetuar përgjegjësinë penale juridike të tij.

Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin ndaj të akuzuarit gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat në kuptim të dispozitave të nenit 73 të KPRK-ës të cilat ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit, prej rrethanave lehtësuese gjykata ka vlerësuar rrethanat personale të akuzuarit: është baba i 2 fëmijëve, gjendjen e tij ekonomike, është mbajtës i vetëm i familjes, pendimin e tij dhe premtimin se në të ardhmen nuk do përsërisë veprën penale, pranimin e fajësisë, sjelljet tejet korrekte në gjykatë, e sidomos faktin se për herë të parë ndeshet me ligjin, mos dënushmërinë e tij të mëparshme, ndërsa si rrethana rënduese Gjykata muar parasysht, peshën e veprës penale, rrethanat në të cilat është kryer vepra, të gjitha këto rrethana ndikuan që Gjykata të njëjtit të shqiptojë dënim me burgim në kohëzgjatje prej 120.-(njëqind e njëzet)ditësh, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari brenda kohës së verifikimit në afatin prej 1(një) viti, nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale, me bindje se edhe me këtë dënim do të arrihet efekti dhe qëllimi i tij nga neni 41 dhe 50 i KPRK-së dhe ky dënim i tillë i shqiptuar sipas bindjes së gjykatës është në proporcion me veprën penale të kryer dhe me rrethanat personale të cilat i posedon i akuzuari.

Vendimi për udhëzimin e palëve të dëmtuara në kontest civil, për realizimin e kërkesës pasurore juridike, është marrë bazuar në nenin 463 par.2 të KPPK-ës.

Vendimi mbi shpenzimet e paushallit gjyqësor, dhe shpenzimeve të procedurës penale, është marr komfor nenit 450 par. 1 dhe 2 nën paragraf 2.1 dhe 2.6 të KPPK-së.

Nga sa u tha më lart u vendosë si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË,

Departamenti i përgjithshëm
P. nr.447/17 më datë 18.07.2018

Sekretarja juridike,
Lamije Kuqi

Gjyqtarja e vetme gjykuese
Diana Sina

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Aktgjykimi është e lejuar ankesa në afatin prej **15 ditësh**, nga dita e marrjes së tij në dorëzim, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmes kësaj Gjykate.